



Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në bazë të nenit 28 paragrafi (3), në lidhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta Zyrtare" nr. 145/10, 136/11, 41/14 dhe 53/16), në seancën e mbajtur më 31.08.2016 miratoi si vijon

Udhëzime për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve Komisionit për Mbrojtjen e konkurrencës zakonisht vërteton se të njëjtat janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës¹

I. HYRJE

1. Në këto Udhëzime vërtetohen rastet në të cilat Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni) zakonisht vërteton se përqendrimet e caktuara për të cilat është parashtruar njoftimi nuk do të kenë për pasojë prishjen e konsiderueshme të konkurrencës efektive të tregut ose pjesës së tij thelbësore dhe të njëjtat janë në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.
2. Përvoja e Komisionit e fituar gjatë zbatimit të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta Zyrtare" nr. 04/05, 70/06 dhe 22/07) dhe Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta zyrtare e Republikës Maqedoni" nr. 145/10, 136/11, 41/14 dhe 53/16), tregon se disa kategori të përqendrimeve për të cilat është parashtruar njoftimi zakonisht janë të lejuara pa pasur ndonjë dyshim të konsiderueshëm se të njëjtat janë në përputhje me dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Ligjit), në qoftë se nuk ka pasur rrethana specifike.
3. Qëllimi i këtyre Udhëzimeve është më afër përcaktimit të kushteve që duhet të përmbushen gjatë vlerësimit të përqendrimeve të parashtruara për të cilin Komisioni, zakonisht miraton një vendim me të cilin vërteton që përqendrimi i parashtruar është në përputhje me dispozitat e Ligjit. Në qoftë se janë plotësuar kushtet e nevojshme të përcaktuara në pikën 6 ose 7 të këtyre Udhëzimeve dhe nëse nuk ekzistojnë rrethana specifike, Komisioni miraton një vendim me të cilin vërteton se përqendrimi është në përputhje me Ligjin (vendimi me të cilin është lejuar përqendrimi), në afat prej 25 ditëve të punës nga marrja e njoftimit të rregullt, në pajtim me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit².

¹ Këto Udhëzime janë në përputhje me Udhëzimet e Komisionit për një procedurë më të thjeshtuar për vlerësimin e përqendrimeve të caktuara në bazë të Rregullores së Këshillit (KE) nr. 139/2004 (2013 / C 366/04)

² Forma dhe përmbajtja e njoftimit janë të përcaktuara në Rregulloren për formën dhe përmbajtjen e njoftimit të përqendrimit dhe dokumentacionit të nevojshëm i cili parashtrohet së bashku me njoftimin („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 44/12).



REPUBLIKA E MAQEDONISË
KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS

Rr. Shën Kirilli dhe Metodi nr. 54 (kati i 6), 1000 Shkup
Tel (02) 3298 666 Faksi (02) 3296 466 www.kzk.gov.mk e-mail: kzk@kzk.gov.mk



4. Megjithatë, edhe në rastet kur janë përmbushur kushtet e pikës 6 ose 7 të këtyre Udhëzimeve, Komisioni mund të miratojë një konkluzion për nisjen e procedurës në pajtim me Ligjin në lidhje me cilin do përqendrim për të cilat është parashtruar njoftimi, veçanërisht në qoftë se mund të zbatohen masat mbrojtëse ose përjashtimet të përcaktuara në pikat prej 9 deri në 18 të këtyre Udhëzimeve.
5. Duke ndjekur procedurën përshkruar në këto Udhëzime, Komisioni ka për qëllim kontrollin e përqendrimeve ta bëjë më të fokusuar dhe me më efikase.

II. Përqendrimet adekuate

6. Komisioni zakonisht do të vërteton që kategoritë e mëposhtme të përqendrimeve janë në përputhje me Ligjin³ :
 - a) Dy ose më shumë ndërmarrje fitojnë kontrollin e përbashkët mbi investimin e përbashkët, nëse investimi i përbashkët nuk ka ose ka aktivitete të papërfillshme reale ose të pritshme në territorin e Republikës së Maqedonisë. Raste të tilla ekzistojnë kur:
 - (i) të ardhurat e investimit të përbashkët dhe/ose të ardhurat nga aktivitetet që i atribuohen investimit të përbashkët⁴ është më i vogël se 1 milion euro në territorin e Republikës së Maqedonisë në kohën e parashtrimit të njoftimit⁵ dhe

³ Kategoritë e mëposhtme zbatohen në mënyrë alternative, e jo në mënyrë kumulative përkatësisht përmbushja e të gjitha kriterëve të cilës do kategori të përmendur në pikën 6 (a), 6 (b) ose (g) ose pika 7 në parim do të thotë se përqendrimi për të cilin është parashtruar njoftimi është në përputhje me Ligjin. Përqendrimi mund ti përmbush kriteret e më shumë se një nga kategoritë e përcaktuara në këto Udhëzime. Prandaj , parashtruesit e njoftimit mund të thirren në njoftimin e përqendrimit të më shumë kategorive të përcaktuara në këto Udhëzime.

⁴ Shprehja „dhe/ose” i referohet situatave të ndryshme, si për shembull:

- në rastin e blerjes së një ndërmarrje, (ndërmarrjes së synuar) të ardhurat që duhen të merren parasysh janë të ardhurat e ndërmarrjes së synuar (investimit të përbashkët),
- në rastin e krijimit të një investimi të përbashkët në të cilën ndërmarrjet udhëheqëse kontribuojnë me (i transferojnë) aktivitetet e tyre, të ardhurat që duhen të merren parasysh janë ato të aktivitetëve të transferuara,
- në rastin e hyrjes të një ndërmarrje të re që ka kontroll në investimin ekzistues të përbashkët, duhet të merren parasysh të ardhurat e investimit të përbashkët dhe të ardhurat e aktivitetëve të cilët mbarten nga ndërmarrja e re udhëheqëse (në qoftë se ka të tilla).

⁵ Të ardhurat e investimit të përbashkët mund të përcaktohet sipas raporteve më të reja revizore për ndërmarrjet udhëheqëse, ose të vetë investimit të përbashkët, varësisht nga disponueshmëria e llogarive të veçanta për burimet e kombinuara në investimin e përbashkët.



REPUBLIKA E MAQEDONISË
KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS

Rr. Shën Kirilli dhe Metodi nr. 54 (kati i 6), 1000 Shkup
Tel (02) 3298 666 Faksi (02) 3296 466 www.kzk.gov.mk e-mail: kzk@kzk.gov.mk



- (ii) vlera totale e mjeteve të transferuara në investimin e përbashkët është më e vogël se 1 milion euro në territorin e Republikës së Maqedonisë në kohën e parashtrimit të njoftimit⁶;
- b) dy ose më shumë ndërmarrje bashkohen, ose një ose më shumë ndërmarrje fitojnë kontrollin individual ose të përbashkët mbi një ndërmarrje tjetër, ku asnjëri nga pjesëmarrësit në përqendrim nuk është i angazhuar në aktivitetet e biznesit të tregut të njëjtë të mallrave dhe tregut gjeografik⁷ ose të tregut të mallrave që është në rritje apo tregut në rënie në krahasim me tregun e mallrave në të cilin merr pjesë çdo pjesëmarrës tjetër në përqendrim⁸;
- c) bashkohen dy ose më shumë ndërmarrje, ose një ose më shumë ndërmarrje fitojnë kontrollin individual ose të përbashkët mbi një ndërmarrje tjetër ku dy kushtet e mëposhtme janë plotësuar:
 - (i) pjesa e përbashkët e tregut e të gjithë pjesëmarrësve në përqendrim që janë angazhuar në aktivitetet e biznesit të tregut të njëjtë të mallrave dhe tregut gjeografik⁹ (marrëdhëniet horizontale), nuk kalon 20¹⁰ %
 - (ii) pjesa e tregut e një ose të gjithë pjesëmarrësve në përqendrim që janë angazhuar në aktivitetet e biznesit të tregut të mallrave i cili është një treg në rritje ose në rënie në krahasim me tregun e mallrave në të cilin merr pjesë çdo pjesëmarrës tjetër në përqendrim (marrëdhëniet vertikale)¹¹, nuk kalon 30%¹²

⁶ Vlera totale e mjeteve të investimit të përbashkët mund të përcaktohet me përgatitjen e fundit dhe të miratuar të bilancit të gjendjes së secilës ndërmarrje udhëheqëse. Termi „mjetet” përfshinë: (1) të gjitha mjetet materiale dhe jo materiale të cilët do të transferohen në investimin e përbashkët (shembujt për mjetet materiale janë kapacitetet prodhuese dhe objektet tregtare për shitjen me shumicë dhe pakicë, rezervat e mallrave; shembujt për mjetet jo-materiale janë pronësia intelektuale, goodwill etj.) dhe (2) çfarë do kredie ose detyrimi i investimit të përbashkët i çfarëdo ndërmarrjeje udhëheqëse pajtohet të vazhdon ose garanton në investimin e përbashkët. Kur mjetet e transferuara gjenerojnë të ardhura, në kohën parashtrimit të njoftimit, atëherë as vlera e mjeteve, e as të ardhurat vjetore nuk duhet të kalojnë 1 milion euro.

Kur mjetet e transferuara krijojnë të ardhura, atëherë as vlera e mjeteve e as të ardhurat nuk mund të kalojnë 1 milion euro.

⁷ Shih Udhëzimet e përcaktimit të tregut relevant për qëllimet e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës

⁸ Lidhja vertikale zakonisht nënkupton se malli ose shërbimi i ndërmarrjes aktive në tregun përkatës që është në rritje paraqesin një imput të rëndësishëm për mallin ose shërbimin e ndërmarrjes aktive në tregun që është në rënie. Shih Udhëzimet për vlerësimet e përqendrimeve vertikale dhe konglomerat.

⁹ Shih fusnotën 7

¹⁰ Pragjet për marrëdhëniet vertikale dhe horizontale zbatohen dhe çdo përkufizim tjetër alternativ i tregut të mallit dhe tregut gjeografik i cili mund të shqyrtohen në një rast të caktuar. Është e rëndësishme përkufizimet themelore për tregjet relevante të përmendura në njoftim, të jenë mjaftueshëm precize për të arsyetuar vlerësimin se këto pragje nuk tejkalohen dhe se janë të përmendura të gjitha përkufizimet e ngjashme alternative të tregut(duke përfshirë tregjet gjeografik që janë më të ngushta sesa ato nacionale).

¹¹ Shih fusnotën 8

¹² Shih fusnotën 10



- d) njëra palë fiton kontrollin individual të ndërmarrjes mbi të cilën tashmë ka kontroll të përbashkët.
7. Komisioni mund zakonisht të vërteton se përqendrimi është në përputhje me dispozitat e Ligjit kur dy ose më shumë ndërmarrje bashkohen, ose një ose më shumë ndërmarrje fitojnë kontrollin individual ose të përbashkët mbi ndërmarrjen tjetër, ku plotësohen dy kushtet e mëposhtme:
- (i) *Pjesa e përbashkët e tregut e të gjithë pjesëmarrësve në përqendrim që janë në marrëdhënie horizontale nuk kalojnë 50%; dhe*
 - (ii) *Rritja (delta) e indeksit të Herfindahl-Hirschman (HHI) që rezulton nga përqendrimi është nën 150¹³¹⁴*
8. Për qëllimet e zbatimit të pikës 6 (b) dhe (v) dhe pikës 7 në rastin e fitimit të kontrollit të përbashkët jashtë fushës së veprimit të investimit të përbashkët, marrëdhëniet që ekzistojnë vetëm ndërmjet ndërmarrjeve të cilët fitojnë kontrollin e përbashkët nuk konsiderohen si marrëdhënie horizontale ose vertikale për qëllimet e zbatimit të këtyre Udhëzimeve. Megjithatë, këto marrëdhënie mund të kenë për qëllim apo efekt harmonizimin e sjelljes së konkurrencës në përputhje me nenin 17 paragrafi (5) të Ligjit, rastet e këtyra janë përpunuar në pikën 15 të këtyre Udhëzimeve.

Masat mbrojtëse dhe përjashtimet

9. Gjatë një vlerësimi nëse përqendrimi bie në një nga kategoritë e përcaktuara në nenin 6 dhe 7, Komisioni do të sigurojë që të gjitha rrethanat përkatëse janë vërtetuar me qartësi të mjaftueshme. Duke pasur parasysh se përcaktimi i tregut relevant mund të jetë një element kyç në këtë vlerësim, palët në përqendrim duhet të japin informacione për të gjitha përkufizimet e mundshme alternative të tregut relevant. Palët në përqendrim janë përgjegjëse për përshkrimin e të gjitha tregjeve të përshtatshme alternative relevante të mallrave dhe tregjeve gjeografike mbi të cilët përqendrimi për të cilin është parashtruar njoftimi mund të ketë ndikim, por gjithashtu edhe për sigurimin e të dhënave dhe informacioneve në lidhje me përkufizimin e tregjeve të tilla. Komisioni

¹³Indeksi HHI llogaritet si një shumë e katrorëve të pjesëve individuale në treg për të gjitha ndërmarrjet në treg: Shih Udhëzimet për vlerësimin e përqendrimeve horizontale për qëllimin e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, në mënyrë që të llogaritet delta e HHI që buron nga përqendrimi, është e mjaftueshme nga shuma e katrorit të pjesëve të tregut të pjesëmarrësve në përqendrim (respektivisht, shuma e katrorit të pjesës së tregut që ndërmarrja e bashkuar do të ketë pas një përqendrimi) të merret shuma e katrorëve të pjesëve individuale të tregut të pjesëmarrësve në përqendrim (sepse pjesa e tregut e të gjitha pjesëmarrësve të tjerë në treg mbetet i njëjtë dhe nuk ndikon në shumën e pjesës së llogaritur). Me fjalë të tjera HHI delta mund të llogaritet vetëm në bazë të pjesëve të tregut të palëve në përqendrim.

¹⁴ Shih fusnotën 10



mban të drejtën të miratoj një vendim përfundimtar në lidhje me përcaktimin e tregut relevant në bazë të një analize të fakteve për një çështje të caktuar. Kur është e vështirë të përcaktohen tregjet relevante ose të përcaktohen pjesët e tregut të palëve në përqendrim, Komisioni zakonisht nuk miraton një vendim në bazë të këtyre Udhëzimeve. Përpos kësaj, në qoftë se përqendrimet përfshijnë çështje të reja ligjore me interes publik, Komisioni zakonisht nuk do të miratoj një vendim në bazë të këtyre Udhëzimeve.

10. Edhe pse mund të supozohet se përqendrimet të cilët plotësojnë kushtet e pikës 6 dhe 7 nuk do të shkaktojnë dyshime serioze nëse ato janë në përputhje me dispozitat e Ligjit, por mund të ketë situata të caktuara që kërkojnë fillimin e procedurës.
11. Shembujt e mëposhtme janë shembuj të rasteve të llojllojshme për të cilët Komisioni mund të miratoj një vendim në përputhje të këtyre Udhëzimeve.
12. Mundësit janë të vogla që Komisioni të miratojë një vendim në bazë të këtyre Udhëzimeve për përqendrim në qoftë se ka/ është i pranishëm disa nga rrethanat e veçanta të theksuara në Udhëzimet për vlerësimin e përqendrimeve horizontale për qëllimet e Ligjit. Kjo përfshin rastet ku tregu është përqendruar tashmë, kur përqendrimi do të eliminojë një forcë të rëndësishme konkurruese, kur përqendrimi për të cilin është parashtruar përqendrimi paraqet një përqendrim në mes të dy novatorëve të rëndësishme, ose kur ka indikacione se përqendrimi për të cilin është parashtruar njoftimi do tu mundësojë ndërmarrjeve që bashkohen të kërcënojnë zgjerimin e konkurrentëve të tyre.
13. E njëjta mund të zbatohet edhe kur nuk mundet në mënyrë precize të përcaktohet pjesa e tregut e palëve në përqendrim. Kjo shpeshherë është një rast kur pjesëmarrësit kur bashkohen veprojnë në tregje të reja ose pak të zhvilluara.
14. Lloje të caktuara të përqendrimeve mund të rrisin fuqinë e tregut të pjesëmarrësve në përqendrim, për shembull, duke i kombinuar burimet teknologjike, financiare apo të tjera, edhe në qoftë se palët në përqendrim nuk veprojnë në të njëjtin treg. Përqendrimet ku të paktën dy nga pjesëmarrësit në përqendrim janë të pranishëm në tregjet fqinjë të lidhura ngushtë¹⁵, gjithashtu mund të tregohen si joadekuatë për të marrë një vendim në përputhje me këto Udhëzime, veçanërisht kur një ose më shumë pjesëmarrës në përqendrim kanë pjesë individuale të tregut prej 30% ose më shumë në cilin do treg të mallrave në të cilin nuk ka marrëdhënie

¹⁵ Tregjet e mallrave janë tregje fqinje të lidhura ngushtë në qoftë se mallrat plotësohen njëra me tjetrën, ose në qoftë se u përkasin një spektri të mallrave që zakonisht blihen nga e njëjta kategori e konsumatorëve me të njëjtin qëllim përfundimtar të përdorimit



horizontale dhe vertikale në mes pjesëmarrësve, por që është një treg fqinjë i tregut në të cilin vepron njëri nga pjesëmarrësit¹⁶;

15. Joadekuatë për miratimin e një vendimi në përputhje me këto Udhëzime mund të jenë dhe përqendrimet për të cilat ekziston çështja e harmonizimit të sjelljes së konkurrencës, siç është potencuar në nenin 17 paragrafi (5) të Ligjit.
16. Ndryshimi nga kontrolli i përbashkët në atë individual mundet, në raste të veçanta, të kërkojë nisjen e procedurës. Shqetësim i veçantë i konkurrencës mund të paraqitet në rrethanat ku ish-sipërmarrësi i përbashkët është përfshirë në grupin ose rrjetin e aksionarit të vetëm të mbetur i cili ushtron kontroll, ndërsa kufizimet e disiplinës që burojnë nga motive potenciale të ndryshme të aksionarëve të ndryshëm që ushtrojnë kontroll janë hequr dhe pozicioni i saj strategjik i tregut mund të forcohet. Për shembull, në rastin kur kompania A dhe kompania B së bashku kontrollojnë një sipërmarrje të përbashkët V, përqendrimi në pajtim ku A fiton kontrollin e vetëm të V, mund të shkaktoj shqetësim në lidhje me konkurrencën në rrethanat kur V është konkurrent i drejtpërdrejt i A dhe ku V dhe A së bashku do të kenë pozitë të konsiderueshme të përbashkët në treg dhe kur me këtë hiqet shkalla e pavarësisë që më parë e kishte V. Në rastet kur shembujt e këtillë kërkojnë më shumë analiza, ato janë joadekuatë për të miratuar një vendim në përputhje me këto Udhëzime.
17. Komisioni nuk do të miratojë një vendim në përputhje me këto Udhëzime për përqendrimet tek të cilat më parë Komisioni nuk e vlerësoi marrjen e kontrollit të përbashkët të një sipërmarrje së përbashkët.
18. Në rastin e përqendrimeve të përshkruara në pikën 8, Komisioni do të vendos në mënyrë të veçantë për secilin rast nëse, në përputhje me specifikat e përqendrimit në fjalë rritja e përqendrimit të tregut që e tregon delta HHI, është ose nuk është adekuatë të miratojë një vendim në përputhje me këto Udhëzime.

III. Dispozitat procedurale

Kontaktet para parashtrimit të njoftimit

19. Komisioni konsideron se kontaktet para parashtrimit të njoftimit ndërmjet parashtruesit/parashtruesve të njoftimit edhe Komisioni mund të jetë i dobishëm madje edhe në raste q në shikim janë të lehta. Lëndët (njoftimet e përqendrimeve) që janë përkatës për miratimin e një vendimi në përputhje me këto Udhëzime mund të ngrenë çështje komplekse, si për

¹⁶ Shih Udhëzimet për vlerësimin e përqendrimeve vertikale dhe konglomeratit.



REPUBLIKA E MAQEDONISË
KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS

Rr. Shën Kirilli dhe Metodi nr. 54 (kati i 6), 1000 Shkup
Tel (02) 3298 666 Faksi (02) 3296 466 www.kzk.gov.mk e-mail: kzk@kzk.gov.mk



shembull atë të përkufizimit të tregut (të shihet pika 9) që është më mirë të zgjidhen para parashtrimit të njoftimit. Kontaktet para parashtrimit të njoftimit i mundësojnë Komisionit dhe parashtruesit të njoftimit të përcaktojnë shumën e saktë të informacioneve që dorëzohen me njoftimin. Parashtruesit e njoftimit veçanërisht inkurajohen të kontaktojnë Komisionin para parashtrimit të njoftimit, kur konsiderojnë se përqendrimi i plotëson kushtet e pikës 7. Sipas Ligjit, parashtruesit e njoftimit mund të parashtrojnë njoftimin në çdo kohë, në qoftë se ai është plotë. Mundësia për realizimin e kontakteve para parashtrimit të njoftimit është një mundësi që ju ofrohet parashtruesve të njoftimit nga Komisioni në bazë vullnetare, më qëllim që të përgatisin shqyrtimin formal të njoftimit të përqendrimit. Si të këtilla, edhe pse të padetyrueshme, kontaktet para parashtrimit të njoftimit mund të jenë shumë të dobishme si për parashtruesit e njoftimit ashtu edhe për Komisionin në përcaktimin e shumës së saktë të informacioneve që parashtrohen në njoftim.

20. Megjithatë, kontaktet para parashtrimit të njoftimit, mund të jenë më pak të dobishme për rastet e përfshira në pikën 6 (b) të këtyre Udhëzimeve, përkatësisht në rastet ku nuk ka tregje ku përqendrimi mund të ketë ndikim¹⁷, sepse palët në përqendrim nuk janë përfshirë në aktivitetet e biznesit të të njëjtit treg të mallrave dhe tregut gjeografik, ose në tregun e mallrave që është tregu në rënie apo në rritje i tregut të mallrave në të cilin është i pranishëm çdo pjesëmarrës tjetër në përqendrim.
21. Vërtetimi i mosekzistimit të tregjeve në të cilin përqendrimi mund të ketë një ndikim, duhet të vërtetohet në përputhje me pikën 9 të këtyre Udhëzimeve. Prandaj, mbetet detyrimi i parashtruesve të njoftimit ti paraqesin të gjitha informatat e nevojshme për Komisionin për të përcaktuar se në përqendrim nuk do të ngrehet ndonjë çështje në lidhje me ndonjë treg ku përqendrimi mund të ketë një ndikim. Komisioni nuk do të miratojë një vendim në përputhje me këto Udhëzime në bazë të pikës 6 (b) nëse është e vështirë të përcaktohet se përqendrimi nuk ngre një çështje në lidhje me ndonjë treg në të cilin përqendrimi mund të ketë një ndikim.

¹⁷ Për përkufizimin e tregjeve ku përqendrimi mund të ketë ndikim, shih përkufizimin e dhënë në paragrafin (9) pika 10 të Udhëzimeve për mënyrën e parashtrimit dhe plotësimit të njoftimit të një përqendrimi.